



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT, KONTROLLIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Nr. 474 Prot

Maliq, më 30.01.2024

**Lënda:** Kërkesë për shpallje

**Drejtuar:** Sektorit të Teknologjisë së Informacionit dhe Mardhënieve me Publikun

Këtu

Njesisë Administrative Vreshtas

Në mbështetje të Kreut II, pika 3 të Udhëzimit Nr.1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandarë”, bashkangjitur ju dërgojmë shkresën “Njoftim Publik” me Nr. 473 Prot, datë 30.01.2024, për dhënie me qira të tokës bujqësore të pandarë me Nr. Pasurie 90/40, Zonë Kadastrale 3010, Sipërfaqe 704 500 m<sup>2</sup>, fshati Podgorie, Njësia Administrative Vreshtas, në mënyrë që të bëni të mundur shpalljen e saj në ambientet publike, gjithashtu dhe në faqen zyrtare të webit të Bashkisë Maliq nga ana e Sektorit të Teknologjisë së Informacionit.

Ju faleminderit !

**KRYETARI I BASHKISË**

**Gëzim Topçiu**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KRYETARI I BASHKISË

Nr. 473 Prot

Maliq më, 30.01.2024

**NJOFTIM PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 9, pika 1.2, gërma "a", neni 64, gërma "a", të Ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Ligjit Nr. 8312 datë 26.03.1998 "Për Tokat Bujqësore të Pandara", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.364, datë 01.04.2009 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Vreshtas të Qarkut të Korçës", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.531, datë 21.08.1998 "Për Tokat Bujqësore të Pandara", Udhëzimit Nr.1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara", Kreu I pika 5, Kreu II pika 1 dhe 3, si dhe Vendimit të Këshillit të Bashkisë Nr.71, datë 30.09.2016 "Për miratimin e listave të tokave bujqësore të pandara me qëllim dhënien me qira të tyre, për Njësitë Administrative Pirg, Vreshtas dhe Pojan", i ndryshuar;

Bashkia Maliq, njofton se jep me qira tokën bujqësore të pandarë me ligjin Nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", me Numër Pasurie 90/40, Zonë Kadastrale 3010, Sipërfaqe 704 500 m<sup>2</sup>, Fshati Podgorie, Njësia Administrative Vreshtas.

Të interesuarit të paraqesin kërkesat e tyre pranë Bashkisë Maliq, brenda datës **09.02.2024**.

Ankandi për dhënien e tokës me qira do të zhvillohet në datën **26.02.2024**, ora **10:00**, pranë Bashkisë Maliq.

**KRYETARI I BASHKISË**

**Gëzim Topçiu**